



Permbledhje joteknike e aktiviteteve

“Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit, ID. 7.3, c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari.”

“Industria minerare, ID 3.1, e. Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj.).”



Subjekti: “Kalivioti” sh.p.k

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2023



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje**
- ✚ Baza ligjore**
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit**
- ✚ Objektivat dhe qellimi**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi te zhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 162/2014 “Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligji nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisit tetipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti **"Kalivioti" sh.p.k** me administrator **Z. Vangjel Kalivjoti** eshte regjistruar prane QKB me NIPT J64228811C dhe do te ushtroje aktivitetet: **"ID. 7.3, c. Veprimtarië që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari dhe ID 3.1, e. Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj.)"**. Aktiviteti do te zhvillohet ne adresen Livadhja, Sarande, Vlore.



	GK	
	X	Y
1.	4424635.70	4406565.56



Procesi i punes

Impianti i prodhimit te Asfaltit

Impiant e prodhimit te asfaltit, ka destinacion kryesor prodhimin e konglomerateve bituminoze per nevojat e ekonomise, shtrimin e rugeve automobilistike, shesheve industriale, pista aeroportesh, pista atletike, fusha tenisi etj.

Konglomeratet bituminoze jane perzierje e agregateve inerte (rere, granile dhe mbushes) ne te nxehte me bitum qe sherben si lidhes dhe qe perdoren per asfaltimin e rugeve etj.

Konglomeratet bituminoze kane ngjyre te zeze, me arome karakteristike dhe gjendje fizike viskoze. Temperature e nxehtjes ne furre e perzierjes se inerteve me bitum arrin 1800 c.

Gjithashtu prodhohen konglomerate bituminoze te flohta te cilat kane perdorim te madh ne mirembajtjen e rugeve, riparimin e demtimit te asfalteve te rugeve ekzistuese.

Asfalto-betoni pasi vendoset ne objekt me paisjet dhe makinerite perkatese, nga mase vizkoze gradualisht duke u ftohur ngurtesohet dhe ruan aftesine e elastike. Raportet e lendeve perberese dhe granulometria e agregateve perberes dhe bitumit, realizohen mbi bazen e recepturave te percaktuar nga drejtuesi teknik, per cilesi te ndryshme elasticiteti dhe kompaktesie.

Ne raste te vecanta per prodhime asfalto-betoni me kerkesa specifike, karakteristika te rritura, perdoren per pergatitjen e tij, shtesa te ndryshme, si material gome, ngjyrues, material plastik, cemento etj.

Lendet e para te perdorura ne procesin e prodhimit te asfalto

Rere e lare: 0-5mm

Granil 1: 5-10mm

Granil 2: 10-20mm

Bitum

Nafte

Solar ose mazut

Shtesa te tjera te vecanta sipas recetave perkatese te llojet te prodhimit.

Produktet e asfalto te projektuar

Sipas recepturave te percaktuar nga drejtuesi teknik, ne vartesi te kerkesave te perdorueseve, prodhohen ne impiante keto lloje asfaltesh.



a. Asfalt tip TAPET:

- Rere 46%
- Granil 46%
- Bitum ne raport 48kg/700kg inert ~ 8%

b. Asfalt tip BINDER CHIUSO (Perdoret poshte tapetit)

- Rere 0- 5mm 40%
- Granil 5-10mm 20%
- Granil 10–20mm 40%
- Bitum ne raport 33%

c. Asfalt tip BINDER APERTO (Perdoret per mbushje poshte tapetit)

- Rere 0-5mm 30%.
- Granil 5-10mm 20%
- Granil 10-20mm 50%
- Bitum 30%

d. Asfalta me fraksione te trasha

e. Asfalt i ftohte

Keto asfalte prodhohen me emulsione qe perdoren per ngjitjen e asfaltit me shtresat e tjera te inerteve te rruges te paasfaltuar ose me nje asfalt te vjeter.

Ky pergatitet me keto perberesa:

Bitum

Uji

Emulstab (Stabilizator i emulsionit).

Acid Bit.

Gjendja e lenget, trasportohet ne fuci ose bote.

Makinerite dhe pajisjet ne perberje te impiantit te prodhimit te asfalto

Impiant e asfaltimit e instaluar nga shoqeria “Kalivioti” Shpk perbehet nga paisjet, makineri dhe instrumenta komandimi, si vijon:

Bunkeri inerteve me tre ndarje x 5m3 secili

Transportjeri i inerteve.

Furra cilindrike e rrotullushme per nxehjen e inerteve

Depozitimi i bitumit me kapacitet 3X50 ton

Depoja e solarit dhe mazutit, me kapacitet 10 ton

Depozita e naftes



Peshorja

Ventilatori i ajrit.

Filtrat

Aspiratori i kapjes se pluhurave dhe tymrave

Kaldaja per ngrohjen e inerteve, solarit dhe bitumit

Perzieresi

Pulti i komandimit te procesit te prodhimit te asfalto-betonit

Transportieri i produktit te gatshem

Bunkeri i produktit te gatshem te asfalto - betonit


Depozitat e naftes, te solarit dhe mazutit mbushen ne rastet kur impianti me kontrate prodhon asfaltobeton. Ne kete kohe kur impianti nuk punon ato mbahen bosh dhe nuk jane burim i vazhdueshem rreziku per zjarr ose demtim te ambientit nga derdhjet e ketyre lendeve ne toke.

Pavaresisht sa me siper nga subjekti jane marre masa per te shmangur shperndarjen e ketyre lendeve ne ambjent kur depozitat demtohen. Per rreth tyre jane ndertuar gropa ku mblidhet nafta, solari apo mazuti i derdhur.

Gjithashtu subjekti pervec impiantit te prodhimit te asfalto-betonit ka ne perdorim nje numer te konsiderueshem paisje e makineri per ngarkimin e inerteve, transportin e inerteve, transportin e konglomerateve qe prodhon impiant, shtrimin e asfaltobetonit ne toke, vibrimin dhe ngjeshjen e tij.

Impiant Prodimit te Betonit

SKEMA TEKNOLOGJIKE E IMPIANTIT





I- Njesia e ruajtjes dhe ngarkimit te agregateve

- Set i plote i mureve anesore dhe i mureve ndarese per 180 m³, kapacitet ruajtjes se agregateve ne 4 ndarje.
- Skelet celiku rezistent per njesine e agregateve, mbrojtje me galvanizim tenxehte, duke perfshire portat e ngarkeses dhe te peshuarit dhe rripin transportier , i pershtatshem per instalimin e mureve anesore dhe ndarese me kapacitet maksimal ruajtje, 180m³ te ndara ne 4 kompartimente.
- Kater porta ngarkese me galvanizim te nxehte, te pershtatshme per agregatet e shtypur apo te rrumbullaket me kokrriza me permasa standarte deri ne 40 mm. Porta ngarkese qe funksionojne ne menyre elektròpneumatike me 4 cilindra, me valvul solenoidi me veprim te dyfishte dhe shkarkese te shpejte, instaluar prane cilindrave dhe pozicion i hapjes i rregullueshem. Te gjitha portat jane te pajisura me pllaka sigurie per te shmangur rrjedhjen e materialit jashte gorgulles peshuese gjate mbylljes se portave.
- Dy pllaka vibruese ne dy ndarjet e reres per te lehtesuar rrjedhjen e reres (*Netotal 4 pllaka vibruese te instaluar*).
- Gorgull peshuese per agregatet me nje volum uji prej 7000 litrash per te ngarkuar deri ne 3 m³.
- Dy vibratore elektrike te pershtatur poshte dy ndarjeve te reres jashte gorgulles peshuese per nje shkarkim te lehte.
 - Trashesia e pllakave te celik
 - Muret anesore dhe ndareset 4mm
 - Portat ngarkuese: 6mm mbylles :10mm
 - Ngarkuesi i agregateve :4mm

Njesi peshuese elektrorike per agregate me kapacitet total prej 10.000 kgme ane te 4 qelizave ngarkuese , mekonform normave KE dhe me ngarkese maksimale prej 5000 kg secila.

- Njesi matese dhe indikator dixhital te instaluar ne bordin e kontrollit.

Nje rrip transportier per peshimin dhe terheqjen e agregateve - gjeresi 800 mm,

Distance qendrore 10,0 m-kapacitet transportues 320 m³ /ore -Fuqi e motoritelektrik 15 kW.

• **Karakteristika te transportierit:**

Strukture e galvanizuar. Rrip gome i tipit 315 (mbulesa e sipërme 3 mm - mbulesa e poshtme 2 mm me dy inserte polyester/nailon . Trashesi totale 6.6 mm).Cikrik drejtues i mbuluar me gome per te shmangur rreshkitjen; Cikrik i pasme me nje mjet gerryese rregullueshem per nje pastrim me te mire te shiritit. Kushineta te sipërme te tipit 3seksionesh, te grasatuara ne menyre te vazhdueshme dhe te vendosura ne distance 400mm midis akseve. Kushineta te poshtme me spirale pastruese te pershtatura ne 2 m distance.Rripi ka nje rrjete mbrojtese anesore dhe nje ndalim emergjence me kavo ne te dyja anet

- **Njesia pneumatike:**

Nje Kompresor me dy faza.thithje e ajrit 670 l/min.; kapacitet depozite 270 l menje filter vaji, rregullator presioni, sistem drenimi me kondensim dhe motorelektrik 3x 3 kw.

Njesi pneumatike per te cilitar ajer te presuar'te valvulat solenoidale me anete nje filtri, valvul e reduktimit te presionit ,manometer dhe lubrifikues. Ky jepet i para-mbledhur ne njesine e agregateve.Fabrike pneumatike me ane te linjave te tubave dhe te pershtatjes se tubave nepikat e shumta te perdorimit.

II- Pajisje ngrites me kosh per agregatet per te ushqyer perzieresin.



Nje kosh ngrites me shkarkim nga poshte, per te ngritur agregatet e ngarkuara dhe per te ushqyer perzieresin. -Kapaciteti 3.500 litra , -Shpejtesi ngritese/zbritese 24 m/min.-I plotesuar me shina dhe celesa kufizimi per te kontrolluar koshin "poshte" "prit","larte" dhe celes i urgjences perpozicionin "shume i larte " dhe "litar i lire", - Motor me pauze automatike 22kw -menyre ngritjeje ortogonale me aksin ekoshave lineare te agregateve.

III- Platforme mbeshtetese perzierese

Konstruksion celiku tip vincure rezistent projektuar per te mbeshtetur gorgullen (hinken) pritese per leshuesin e agregateve, cimentos dhe ujit dhe perzieresin icili mbeshtetet mbi kater me dysheme mbeshtetese pershtatur me nje ure per lartesi me doreza per mbeshtetje perzieresit dhe njesive ngarkuese. Structura prej celiku per te mbledhur gorgullen pritese te agregateve, peshuesine cimentos dhe ujit. Me shkalle per t'u ngjitur nga toka. Lartesia e shkarkimit te betonit 4.1 m nga niveli I tokes.



IV- Njesia e ngarkimit te cimentos

Koshi per peshimin e cimentos i formuar per shkarkim optimal dhe i pajisur me vibrator elektrik dhe me valvule shkarkimi e kontrolluar ne menyre elektropneumatike me flutur te veshur me poliuretane dhe nje guarnicion gome. Kapaciteti i koshit peshues 1.500 litra per t'u ngarkuar deri ne 1.200 kg.

Njesi peshimi elektronike me kapacitet 1.000 kg me ane te 3 qelizave ngarkuese dhe konform normativave te KE dhe me ngarkese maksimale 1.500 kg secila. Njesi matese dhe indicator dixhital te instaluar ne bordin e kontrollit. Njesi pneumatike per te cuar presionin e ajrit ne njesite e fluidizimit ose te filtrat, e pajisur me filter, manometer per reduktimin e presionit (jo ajer i lubrifikuar). Lubrifikuar per dergimin e ajrit ne valvulen flutur.

V- Njesia e ngarkimit te ujit



Koshi per peshimin e ujit, volum 600 lit teresisht i galvanizuar, i plotesuar me valvula ushqyese dhe shkarkuese prej solenoidi qe funksionojne ne menyre elektropneumatike. Njesi peshimi elektronike me kapacitet 600 kg, me ane te nje qelize ngarkuese konform normativave te KE dhe ngarkese maksimale 1.500 kg secila- Njesi matese dhe indicator dixhital te instaluar ne bordin e kontrollit.

VI- Filter ajri per shkarkimin e perzieresit

I instaluar mbi perzieresin dhe perfshin: Mjet pastrues permjet vibrimit shkundes, filter tekstili siperfaqe filtruese 12 m².

VII- Njesia e perzierjes

1 perzieres i detyrueshem me bosht te dyfishte i tipit 3000/2000. Perzieres i detyrueshem me bosht te dyfishte me dy zona perzierje me ane te boshteve te sinkronizuara me kunder rrotullim.- Dhome perzierje e veshur me pllakarezistente ndaj gerryerjes te zevendesueshme.- Krahe perzieres te zevendesueshem temberthyer ne boshtet perzieres. - Lopata perzierese te rregullueshme dhe te zevendesueshme te derdhura ne hekur Ni-Cr rezistente ndaj gerryerjes.-N.2 motorre elektrike me rrip transmisioni.-V dhe kuti ingranazhesh te lidhura me nje vaske vaji. Guamicione speciale te boshtave me njesi automatike grasatimi e plotesuar me depozite grasoje dhe me indikator per renien e nivelit.

➤ *Te dhenat teknike kryesore:*

- Veshja e dhomes se perzierjes Hekur i derdhur HB 600- 17 mm. Trashesi
- Muret anesore vertikale Pllaka celiku te terno-ngurtesuara HB500-12 mm trashesi
- Lopata perzierese Hekur i derdhur HB 600-27 mm trashesi
- Kapacitetmbushes i thate 3.000 lit
- Nxjerrja ne betontefresket 2.400 lit
- Nxjerrja ne betontevibruar 2.000 lit
- Fuqi e motorit elektrik 2 x 37 kw
- Dere shkarkuese 1
- Lopata perzierese 16
- Lopatagerryese 4
- Permasat maks.te agregateve te shtypur I te rrumbullaket: 120/150 mm per 12 %
- Fumizim me energji 380/660 -50 Hz

Portat e shkarkimit funksionojne ne menyre hidraulike me nje pompe elektrike 1,5Kw.E plotesuar me nje pompe urgjence manuale per te hapur portat e shkarkimit ne rast te nderprerjes se energjise.

VIII- Gorgulla e shkarkimi

Nga perzieresi ne kamionin perzieres e bere nga flete celiku, perfshi nje tub gome.

IX- Bordi i kontrollit elektrik

Bord kontrolli elektrik me kontrole te centralizuara te te gjitha pajisjeve per funksionimin e fabrikes paneli i kontrollit perfshin te gjitha komponentet e energjise dhe butonat dhe celesat e zgjedhur me sinoptike qe tregojne nje pamje simbolike te fabrikes me llamba sinjalizuese. Kablo elektrike per te gjitha lidhjet. Shenjat e sigurise sipas normativave te BE.

X- Njesi kontrolli automatiek cifa Pc-Batch.

Sistem automatik per te menaxhuar dhe kontrolluar ne menyre automatike fabriken e ngarkimit, modeli PC-BATCH.

Funksionet kryesore: - Menaxhim i tere fabrikes se perzieries,- Kontroll ne kohe reale i parametrave te ndryshueshem te programit te te tregojne me ane te nje paneli sinoptik funksionimin e fabrikes.Kontroll dhe menaxhim i ciklit te plote te prodhimit (ngarkese dhe



peshim i komponenteve te ngurte dhe te lenget) te azhurnojme konsumin e komponenteve. - Ruajtje e recetave me kapacitet te pafund ne varesi te kapacitetit te HD (hard diskut). - Menaxhim i alarmeve dhe ngjarjeve. -Ruajtje e te dhenave te proceseve me mundesine per te printuar statistikate e prodhimit.

- Bashkeveprim grafik intuitiv i lehte per t'u konsultuar
- Lejon failat e meposhtme :

- 1) Automatik me ane te nje PC (personal computer)
- 2) Gjysme automatik me ane te nje kontrolli manual te treguar ne PC
- 3) Panel manual nga nje tastiere
 - mundesi per programe te jashtme parametrat e ne Office Windows te pershtatshme (ACCESS)
 - planifikim i gjere i prodhimit me ane te nje funksioni menaxhues te shpemdardjes
 - bileta shpemdarese te printuara
 - Menaxhim i mallit gjendje
 - Menaxhim i shenimeve te dergeses per shitjen e nj eprodukti te vetem.
 - Shenimet per transfertat e dergesave dhe azhurnim ne HOST computer memodern Icd/net.
 - Shto kontroll efektiv

I pajisur me:

- Programe per PC dhe PLC
- N.I LAPTOP personal kompjuter original,IBM, HP, SIEMENS, COMPAQ, ACER, ne varesi te disponueshmerise dhe evoluimit te njohurive teknike.
- N I PLC i plote me zona ndarese I/O per te menaxhuar ciklin. rranpall automatik(Sala
- N.I terminali PLC qe shfaq parametrat e ujit dhe shtesave gjithashtu nga paneli .

XI- Sonde per lageshtine me vellim

Dy sonda te tipit "me vellim", te rregulluara per te dialoguar me sistemin ngarkues automatik, sonda te pozicionuara ne koshat e reres.Sistemi mat permbajtjen e lageshtise se reres ne perqindje vlere e cila merret parasysh per te kompensuar raportin rere/uje duke rritur ngarkesen e reres dhe ne menyre respektive duke zvogeluar vleren e ujit.

➤ Opsione, njesi ngarkuese e lengut shtese

Ngarkues-peshues i shtesave 25 lt me qelize ngarkuese te perbere nga:

Nje cilindër me nje tub akriliku transparent te formuar, me flanaxha te galvanizuara dhe nje terheqes veshur me tunxh, me nje liste te graduar jashte.Trashesia 5mm. Nje pompe me motor me bllok cilindrash me vetendezie, nxjerrja $Q = 40$ l/min.Klasi E, HP 0,8- motor tre-fazesh 380V - 50 Hz valvula te njesise se thithjes, valvule sferë pneumatike 1", n.1 rubinet Yz" per larje cilindri, reduktim %" per larje me uje te hyrjes se cilindrit, dollap. I veshur me zink dhe i Iyer me spruco.(400x400x 1 000 mm), sistem peshimi automatik i pajisur me nje qelize ngarkuese per cdo zone ndarese dhe sistem kontrolli automatik dhe nje amplifikues per menaxhimin e instrumentit.

➤ Silos cimentoje

Tresiulosa cimentoje modeli SP 50(kapacitet teorik 50 m³-70 ton perafersisht).Diametri3.500mm i perbere nga panele:vertikale te transportueshem per t'u bashkuar me bulona. I pajisur me :

- doreze ne maje te silosit
- tub ngarkim shkarkimi standard DN 100 per mbushje automatike.
- kembe mbeshtetese



- valvule sigurie kunder mbi presionit gjate veprimit te mbushjes dhe nen - presionit gjate veprimit te nxjerrjes.

Nje kuti e galvanizuar bulonash per ngritjen dhe guarnicionet 3 shkalle ne maje te silosit 3 filter cimentoje 24,5 m² per t'u montuar ne catine e silosit, trup celiku qe nuk ndryshket me tuba filtrues te brendshem me material te rende te pastruar me sistem me presion ajri me kunder rrjedhje me karte elektronike -output maksimal 2.500 m³/ore.

Indikatore elektro-mekanike te nivelit ne tension te ulet me helike te kthyeshme dhe kanxha kemisha per t'u salduar ne trupin e silosit-Llamba sinjalizuese dhe alarm akustikte instaluar ne bordin e kontrollit.Ure me doreza per kalim ne te gjithë silosin.

➤ **Kabina e kontrollit**

Nje kabine e izoluar modeli Personal 38, dimensionet metra 3,2 x 2,2 x 2,4lartesi.-Per t'u vendosur ne nivelin e tokes -E plotesuar me dere hyrjeje te mbyllshme, me nje dritare qe hapet, dy dritare fikse, pajisje per drite elektrike me nje celes ndihmes.

➤ **Helikat e ngarkimit te cimentos**

Tre transportiere cimentoje me elike per ngarkimin e cimentos secili i perbere nga: dinamo 219 mm distance midis portave hyrese - dalese 7,880 mm- motor elektrik 11kw output 50 t/ore-helike me hap te ndryshueshem.Mbeshtetesve te -lubrifikues.Valvul e flutur manual dhe fabrike fluidizimi me 4 pllaka per siloset e cimentos.

➤ **KUSHTET E PAJISJEVE**

PAJISJET NE ANE TE LYERA 400V -50 Hz

Pothuajse e gjithë fabrika eshte e galvanizuar , dmth.:- skelet baze per njesine e agregateve, ngarkues i agregateve, portan garkuese, mure anesore, gorgull e agregateve (pjesezat e brendshme, nuk jane te perfshira).

- Strukture me rrip te dhembzuar dhe aksesoret e lidhur me te.
- Strukture celiku si: mbeshtetesi i njesise se agregateve, shkalle .
- Artikujt e meposhtem te siguruar jane lyer me GRI RAL 7035 (pyesni zyren per ngjyrat e tjera);
- Silos per ruajtjen ecimentos dhe aksesore.
- Ngarkues i cimentos
- Helika ngarkuese
- Perzieres dhe pajisje ngritese me kosh:
- Cikli i lustrimit: pllake per heqjen e skorjeve - dora e pare e
- Bojes, Trashesi minimale 60 mikron, dora e dyte e bojes me
- Tharje te shpejte, minimumi 40 mikron.
- Cikli i galvanizimit sipas EN ISO 1461
- Sgrasatimi(uje dhe sode ose solucion acid) - pastrim i
- Skorjeve (me acid hidroklorik dhe / ose sulfuric)- Flussaggio (me klorid zinku dhe solucion amoniumi)-Paranxehja (90 grade-120)- banje zinku (440 -460 gradeC)ftohje



2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Gjeografia e zones

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti qe kerkohet per shfrytezim, eshte terren kodrinor. Vete terreni ku kerkohet marrja e Deklarates Mjedisore eshte i zhveshur. Kuota e poshtem e zones se kerkuar per shfrytezmi eshte +140 ndersa ajo e sipërme +1708m. Nga pikpamja topografike objekti ka formen e nje structure monoklinale me shtrirje te pergjithshme me azimuth 180° dhe me renie Lindore me azimuth renie 90° dhe kend renie te terrenti 15°.

Popullesia

Popullesia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore dhe blektorale. Ata banojne ne fshatrat perreth me rreth 1500 banore, qe bejne pjese ne fshatin sopic. Livadhja etj. Qendra administrative rurale eshte komuna e Livadhjas.

Klima

Objekti i kerkuar ben pjese ne zonen fushore kodrinore te zones klimatike mesdhetare bregdetare. Klima ne rajonin ku do te kryhen punimet e shfrytezimit dhe perpunimit te gurit gelqeror paraqitet kontinentale me dimer relativisht te bute dhe vere te fresket dhe te ngrohte. Dimri nuk eshte i ashper por me lageshti i cili shoqerohet shpesh dhe me rreshje shirash. Ne zone ka mbi 1750 ore ndricim dielli, korriku 2895 ore dhe dhjetori 105 ore. Temperature mesatare vjetore e ajrit eshte 16.6 grade Celsius, ne Korrik dhe Gusht temperatura shkon 26-40 grade Celsius, ndersa ne Janar zbret deri ne 6-9 grad Celsius.

Vlera mesatare e rreshjeve shkon ne 2287 mm/vit. Ne Periudhen Tetor-Maj bien 75% e rredhjeve. Lageshtia e ajrit rezulton sipas stineve nga 68% - 74%.

Drejtimi i eres eshte kryesisht Veri Perendim - Juge Lindje qe perputhet me drejtimin e pergjithshem te lugines dhe ne raste te rralla oblik me te.

Ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit te gurit gelqeror, duke mare ne konsiderate masat e parashikuara ne projekt, nuk do te ndikojne ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit.

Nje nga masat kryesore per te parandaluar ngritjen e ngrimcave te pluhurit dhe ndotjen e ajrit, eshte perdorimi i ujit gjate kryerjes se proceseve teknologjike ne karriere dhe atyre te perpunimit te metejshem te gurit gelqeror, si dhe sperkatja e stoqeve te gelqerorit dhe rrugeve te transportit.

Hidrologjia dhe hidrografia e zones

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash, pikerisht ne vendin ku kerkohet Deklarata Mjedisore ndodhet nje proske e ceket, ne te cilen ne stinen e thate nuk rrjedhin ujra, por gjate stines se rreshjeve, neper te rrjedhin me rrembim ujrat siperfaqesore per shkak te pjerrtesise mjaft te



madhe te terrenit.

Bimesia

Vendi ku kerkohet Deklarata Mjedisore eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia. Ne afersi te saj (ne lindje) ne saj te depozitimeve te shkripta fertile eshte e zhvilluar bimesia e ulet ne forme shkurresh dhe barerash. Ne zonen e dherave (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike argjilore) qe i takon kuptave poshte +130m rriten lule dhe bar. Ne kuotat e poshtme ndodhen gjithashtu siperfaqe are te kultivueshme.

Ekonomia e zones dhe aktivitetet kryesore

Popullesia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore dhe blektorale si dhe nje pjese e tyre ne emigracion dhe ne aktivite te tjera pak te zhvilluara. Relativisht eshte ne gjendje ekonomike mbi mesatare. Kohet e fundit zona ka marre zhvillim te dukshem si rezultat i shtimit te aktivitetit te shfrytezimit te pllakave te gurit gelqeror si dhe nje angazhim ne turizmin bregdetar.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Shkarkime ne uje

Nga procesi i prodhimit te asfaltit nuk do te kemi gjenerim te shkarkimeve ne ujerat siperfaqesore dhe kanalizime pasi nuk perdoret ne procesin teknologjik te prodhimit te asfaltit. Uje do te perdoret vetem gjate procesit te prodhimit te betonit ku sasia do te jete e percaktuar pa humbje. Gjate zhvillimit te aktivitetit ne impiantin e fraksionimit nuk perdoret uje ne proces por vetem per uljen e perqendrimit te pluhurave ne mjediset e punes. Theksojme se nuk do te kete shkarkime industriale.

Emetimet ne ajer

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te kemi emetime te lehta ne ajer ne mjediset e jashtme. Ky emetim do te vije si pasoj e clirimit te gazeve dhe te grimcave te pluhurit nga levizja e automejteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare. Gjithashtu emetime do te kemi gjate zhvillimit te procesit te formimit te asfaltit ne kaldaje. Vlen per tu theksuar se keto shkarkime jane nen norma dhe normale te krahasueshme me cdo aktivitet te te njejtit lloj.

Zhurmat dhe vibrimet



Ne mjediset e jashtme zhurmat dhe vibrimet do te jene prezent gjate levizjes se automejteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare si dhe gjate zhvillimit te procesit te formimit te asfaltit dhe te betonit. Keto emetime jane ne norme dhe nuk jane shqetesuese per zonat e banuara duke u nisur nga vete fakti se subjekti ka nje largesi te konsiderueshme me objektet e banuara.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i prodhimit te asfaltit jane fraksione te vogla te cilat rifuten perseri ne procesin teknologjik. Gjithashtu e njehta gje ndodh dhe per aktivitetin e prodhimit te betonit ku gjenerohen fraksione te vogla betoni te cilat rifuten perseri ne procesin teknologjik. Pra gjate procesit te formimit te betonit dhe te asfaltit nuk do te kemi gjenerim te mbetjeve te ngurta.

Mbetjet e vetme te cilat do te gjenerohen jane ato nga zhvillimi i aktivitetit te perditshem te punonjesve si kartona apo plastika do te grumbullohen si fillim ne vendin e percaktuar nga drejtuesit dhe me pas do te dergohen ne vendin e percaktuar nga Njesia e qeverisjes vendore. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Ndikime ne biodiversitet

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti nuk do te kemi ndikime ne biodiversitet. Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat per shkarkimet ne uje

Nga procesi i prodhimit te asfaltit nuk do te kemi gjenerim te shkarkimeve ne ujerat sipërfaqesore dhe kanalizime pasi nuk perdoret ne procesin teknologjik te prodhimit te asfaltit. Uje do te perdoret vetem gjate procesit te prodhimit te betonit ku sasia do te jete e percaktuar pa humbje. Gjate zhvillimit te aktivitetit ne impiantin e fraksionimit nuk perdoret uje ne proces por vetem per uljen e perqendrimet te pluhurave ne mjediset e punes. Theksojme se nuk do te kete shkarkime industriale.

Masat per emetimet ne ajer

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te kemi emetime te lehta ne ajer ne mjediset e jashtme. Ky emetim do te vije si pasoj e clirimit te gazeve dhe te grimcave te pluhurit nga levizja e automejteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare. Gjithashtu emetime do te kemi gjate zhvillimit te procesit te formimit te asfaltit ne kaldaje. Vlen per tu theksuar se keto shkarkime jane nen norma dhe normale te krahasueshme me cdo aktivitet te te njejtit lloj.



Subjekti do te kujdeset qe te gjitha automjetet qe bejne te mundur transportin e lendes se pare dhe lendes perfundimtare te jene te kolauduara dhe ne gjende te mire pune. Gjithashtu per uljen e perqendrimit te grimcave te pluhurit, subjekti ne periodhe te thate do te realizoje sperkatjen e ambjenteve te jashtme me uje.

Zhurmat dhe vibrimet

Ne mjediset e jashtme zhurmat dhe vibrimet do te jene prezent gjate levizjes se automejteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare si dhe gjate zhvillimit te procesit te formimit te asfaltit. Keto emetime jane ne norme dhe nuk jane shqetesuese per zonat e banuara duke u nisur nga vete fakti se subjekti ka nje largesi te konsiderueshme me objektet e banuara.

Per te ulur ne sasi te larte prezencen e zhurmave dhe vibrimeve ne mejdiset e jashtme, do te tregohet nje kujdes i vecant per te shkurtuar oraret e prezences se automjeteve te transportit te lendes se pare dhe lendes perfundimtare ne subjekt si dhe levizja e ketyre automjeteve te jete me shpejtesi te ulet.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i prodhimit te asfaltit jane fraksione te vogla te cilat rifuten perseri ne procesin teknologjik. Gjithashtu e njejta gje ndodh dhe per aktivitetin e prodhimit te betonit ku gjenerohen fraksione te vogla betoni te cilat rifuten perseri ne procesin teknologjik. Pra gjate procesit te formimit te betonit dhe te asfaltit nuk do te kemi gjenerim te mbetjeve te ngurta.

Mbetjet e vetme te cilat do te gjenerohen jane ato nga zhvillimi i aktivitetit te perditshem te punonjesve si kartona apo plastika do te grumbullohen si fillim ne vendin e percaktuar nga drejtuesit dhe me pas do te dergohen ne vendin e percaktuar nga Njesia e qeverisjes vendore. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

Detyrimet e punëdhënësit

Per te shmangur aksidentet ne pune, punëdhënësi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Detyrimet e punëmarrësit:



- Të njoh mirë procesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojnë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.